



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 10.

Prishtinë, më 16.02.2015 në ora 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Blerim Shala, Luljeta Veselaj - Gutaj, Rustem Mustafa, Vjosa Osmani, Ilir Deda, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Arben Gashi dhe Slobodan Petroviq.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 10.2.2015 ;**
- 3. Raportimi i ministrit për Integritet Evropian, lidhur me procesin e Integritetit**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua.

- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 10.2.2015 .**

Procesverbali u miratua me vërejtjen teknike të Luljeta Gutaj-Veselaj.

- 3. Raportimi i Ministrit për Integritet Evropian lidhur me procesin e Integritetit;**

Kryetarja Teuta Sahatqija: i uroi fillimisht mirëseardhje ministrit dhe theksoi se në kuadër të fushëveprimtarisë së Komisionit për Integritet Evropian, kemi paraparë ti ftojme disa ministra për raportim në lidhje me integritet Evropian.

Falënderoj ministrin për raportin me shkrim të detajuar, por herëve të tjera kërkoj që paraprakisht të dërgohet një raport me shkrim, së paku 4 ditë para mbledhjes, në mënyrë që anëtarët e komisionit të parashtrijnë pyetje rreth raportit.

Ministri Bekim Çollaku: falënderoi për ftesën dhe mundësinë e dhënë që bashkërisht të diskutojnë për agjendën evropiane. Rreth raportimit tha se kishte menduar se do të jetë raportim gojor, por në të ardhmen do ta ketë parasysh që raportin me shkrim ta dërgojë me kohë. Meqë është raportim i parë mendoj që në këtë takim mos të raportojë për të gjitha prioritetet, por do ta orientoj tërë fokusin në dy prioritetet kryesore për këtë vit, nënshkrimi i MSA-së dhe përmbyllja e suksesshme e dialogut për liberalizimin e vizave me BE-në, duke mos lënë anash edhe obligimet tjera të cilat derivojnë nga mandati dhe legjislacioni në fuqi.

Sa i përket MSA-së, procesi po ecën mirë dhe sipas dinamikës së paraparë. Pjesa dërmuese e punës në këtë proces është përmbyllur, deri në këtë fazë, kemi përmbyllur me sukses negociatat me BE-në dhe në dokumentin përkatës kemi vënë edhe inicialet e para, mirëpo, dokumenti si i tillë mbetet ende i hapur deri në nënshkrimin e tij përfundimtar dhe ky nënshkrim pritet të bëhet në fillim të këtij viti, respektivisht nëse i referohemi premtimeve që kemi marrë nga Komisioni Evropian, diku kah fundi i kësaj pranvere, mirëpo, gjithçka tash për tash mbetet në dorën e Komisionit Evropian.

Marrëveshja është në procedurë të përkthimit në gjuhët zyrtare të BE-së, për tu dërguar pastaj për miratim në Kolegjin e Komisionarëve dhe në Këshillin Evropian për miratim, si procedurë e fundit para nënshkrimit të MSA-së.

MSA-ja është dokumenti i parë ligjorë që Kosova nënshkruan me BE-në. Përfaqëson bazën ligjore për të gjithë hapat e radhës, në kuadër të procesit integruar të Kosovës, deri në aktin e anëtarësimit. Marrëveshja e radhës që do të nënshkruhet, do të jetë Traktati i Anëtarësimit. Nuk pres ndonjë risi në vazhdimësi të këtij procesi sepse të gjitha shqetësimet që kanë qenë gjatë gjithë fazës së këtij procesi, kanë qenë nga 5 shtetet anëtare, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, por hë për hë nuk kemi asnjë lloj dyshimi serioz që mund të na jep ndonjë indikacion se ky proces mund të ndërlikohet më tutje.

Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave me BE-në, tha se kemi arritur në fazën finale të zbatimit të të gjitha kriterëve të kërkuara me Udhërrëfyesin për Viza.

Procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën ka filluar në janar të vitit 2012. Udhërrëfyesi është dorëzuar në qershor 2012.

Deri më tani, Komisioni Evropian ka organizuar 2 misione vlerësuese në Kosovë dhe ata kanë inspektuar gjendjen faktike në terren sa i përket përmbylljes së kriterëve. Rekomandimet e fundit të dala nga komisioni vlerësues gjatë verës së vitit të kaluar, kanë qenë pozitive, por kanë dhënë edhe një pasqyrë të ngecjeve në përmbylljen e detyrave që kanë mbetur ende në këtë proces.

Ngecjet në zbatimin e planit ndërlidhen me zhvillimet politike në vend gjatë 6 mujorit të dytë të vitit, pasi që disa veprime duhet medoemos të kalojnë përmes Kuvendit dhe Institucioneve tjera të pavarura.

Me formimin e Qeverisë së re, kam menduar se do të ketë dinamikë të shtuar në këtë proces, mirëpo, fatkeqësisht edhe në takimin e fundit që kemi mbajtur me Komitetin drejtues për liberalizimin e vizave, ende nuk ka ndonjë lëvizje në sektorët kyç, që priten të përmbyllin kriteret e mbetura, sepse pjesa dërmuese e këtyre kriterëve ndërlidhen me një pako të ligjeve, që janë kryesisht të gjyqësorit, në fushën e të drejtave njeriut, me funksionimin e Ombudspersonit dhe funksionalizimi i Këshillit Gjyqësor, kanë lënë pezull shumë gjëra që ndërlidhen me këtë proces, si dhe Ligji për përgjimet elektronike, i cili fatkeqësisht nuk është miratuar në Parlament, por ne si ministri i kemi marrë parasysh të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet që i keni dhënë në Komision, i kemi hyrë punës që sa më shpejt para Kuvendit të sjellim një ligj të ri, që presim të

miratohet. Deri më tani nuk kemi parë një dinamizëm për ti adresuar kriteret e mbetura, por jam optimist që në tremujorin në vijim do të jemi të gatshëm t'i përmbushim kriteret e mbetura në këtë proces.

Sipas marrëveshjes me Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare, ne si Ministri e Integritimeve Evropiane, pasi që të marrim të gjitha udhëzimet për përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave, do të përpilojmë një raport të hollësishëm, i cili do ti riprocedohet Komisionit Evropian dhe ata do ta vlerësojnë atë, dhe si kanë vepruar herëve tjera, do të dërgojnë misionet verifikuese në terren.

Nga takimi i fundit me drejtorin e përgjithshëm për çështje të brendshme të BE-së, lidhur me liberalizimin e vizave, ata kanë shprehur një dozë skepticizmi sa i përket epilogut të këtij procesi, si pasojë e migrimit të rregullt, mirëpo, prapë se prapë e gjitha do të varet nga përkushtimi i të gjitha institucioneve, sepse ky proces i përfshin të gjitha institucionet, e jo vetëm Qeverinë. Në qoftë se ne jemi të gatshëm që në një periudhë prej tre muajsh të bëjmë një raport përfundimtar me kriteret e mbetura, si nga fusha e legjislacionit dhe nga aspekti i çështjeve teknike që kanë mbetur pa u zgjidhur, mund të mbesim optimist të rezervuar sa i përket një rekomandimi pozitiv nga ana e komisionit në fund të këtij viti. Mirëpo, kjo patjetër duhet të shoqërohet me masa shumë strikte dhe serioze në parandalimin e fenomenit shumë të rrezikshëm dhe shumë negativ për Kosovën, që ndërlidhet me migrimin e parregullt. Ministria jonë e ka mirëpritur Rezolutën e Kuvendit, lidhur me migrimin ilegal dhe jemi ndër të parët që seriozisht jemi duke zbatuar rezolutën.

Kemi nisur fushatë të fuqishme mediale dhe me vizita në terren. Kërkesës i është përgjigjur edhe presidentja dhe kryeministri. Konsideroj se do të ishte mirë që edhe Kuvendi, përveç seancave të ketë edhe takime me qytetarët për të na dhënë një ndihmë edhe neve sepse zëri juaj është shumë më i fuqishëm se zëri i një ministri, që ballafaqohet me qytetarë, sepse ju jeni zgjedhur nga ata dhe i përfaqësoni në mënyrë të drejtpërdrejt interesat e tyre

Teuta Sahatqija, kryetare: në vazhdim pyeti ministrin për nderimin e emërimit të dokumentit prej Planit të Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, në Planin e Veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të dala nga Raporti i Progresit për vitin 2015, përmbajtja është pothuajse e njëjtë, por ka edhe disa lëshime teknike që duhet të përmirësohen.

Më pas pyeti se a pasqyron emri përmbajtjen e dokumentit, kur dihet se këtu hynë edhe kriteret afatmesme të studimit të fisibilitetit, të cilat përfshijnë 8 fusha.

Pas një viti a do të ndryshoj emërtimi i këtij dokumenti dhe a do ta sillni për miratim në Kuvend? Në programin legjislativ të Qeverisë nuk janë paraparë inicimi i dy projektligjeve që parashihen në raportin e Progresit për vitin 2014 dhe si qëndron bashkëpunimi dhe bashkërendimi me Zyrën e Kryeministrit, për përfshirjen e këtyre dy projektligjeve? A do të adresohet kjo çështje e dy projektligjeve apo është paraparë ndonjë formë tjetër e plotësimit të kësaj kërkesë, që del nga Raporti i Progresit?

Cilat masa i keni marrë apo pritni t'i ndërmerrni sa i përket zyrtarëve të rekrutuar në fushën e Acquis, asistencë dhe koordinim të politikave?

A keni kapacitete të mjaftueshme si ministri, lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin në të ardhmen, pas ratifikimit të MSA-së, pra duke filluar me vlerësimin e pajtueshmërisë dhe përshtatjes së legjislacionit vendor me atë të BE-së?

Sa i përket planit nacional për miratim të Acquis, jemi të interesuar për afërsisht të dimë se kur Ministria e Integritimeve mund ta përfundojë këtë dokument sepse do të na ndihmonte si komision, pasi që do ta dimë kohën se cilën pjesë të legjislacionit të BE-së obligohemi ta përshtatim gjatë shqyrtimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së.

Lidhur me procesin e nënshkrimit të marrëveshjes së riintegritimit, sa është e përfshirë ministria e juaj në këtë proces, pasi që e dimë se kryesisht është fushë e MPB-ës dhe e dimë se procesi i riintegritimit do të jetë një proces, i cili për një afat të shkurtër do të bëhet aktual.

Cilat kriterë kanë mbet pa u përmbush në kuadër të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave dhe a ka ndonjë afat të vendosur se kur institucionet vendore do t'i përmbushin ato?

Vjosa Osmani: ngriti çështjen e migrimit që ndërlidhet me liberalizimin e vizave.

Ju thatë se deri më tani nuk keni parë përkushtim të madh për adresimin e kritereve të mbetura që në fakt janë një serë kriteresh që po mbesin dhe po përcillen me vite, sidomos në fushat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Problemi është në atë që ajo që kërkohet nga BE-ja është goxha abstrakte, por ajo që ju sot përmendët është shumë konkrete, pra që janë hartimi i ligjeve nga ministritë përkatëse, hartimi i strategjive që ka të bëjë me parandalimin e trafikimit apo të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e tyre dhe a mund t'na njoftoni se ku qëndron problemi, sepse kjo nuk është diçka, që mund të thuhet se mungon vullneti politik të cilado parti politike dhe vërtet nuk kuptoj pse ministritë përkatëse nuk angazhohen që t'i hartojnë ligjet me kohë sepse është proces urgjent, pyeti Osmani.

Nga ana juaj shtoi më tej Osmani, kemi dëgjuar se viti 2015, do të jetë vit i liberalizimit të vizave. Për dallim nga të tjerët, ju e dini se data kur ne i plotësojmë kriteret mund të jetë datë tjetër, data kur jepet liberalizimi datë tjetër dhe data kur fillon udhëtimi i lirë i qytetarëve datë tjetër, pra janë 3 procese që dallojnë .

Pritjet tuaja si ministri që e koordinoni këtë proces, kur përafërsisht pritni duke e parë dinamikën brenda Qeverisë së Kosovës në bashkëpunim me institucionet tjera që do të plotësohen kriteret?

Pastaj duke i parë raportet që i keni me BE-në, kur pritni që të jepet drita e gjelbër nga Komisioni Evropian dhe duke i pas parasysh procedurat burokratike që janë pas vendimit, kur pritët që qytetarët tanë të udhëtojnë të lirë?

Sa i përket migrimit, Osmani tha se është shumë shqetësuese që një qytetar i Kosovës më tepër i beson një trafikanti se sa një zyrtari të Qeverisë së Kosovës dhe nëse nuk jemi të sigurtë dhe nuk pranojmë se ka krim të organizuar, ka korrupsion dhe nuk ka zhvillim ekonomik dhe se ka humbur shpresa të qytetarët e Kosovës, atëherë fajin nuk mund t'ia lëmë qytetarit, pse i beson më tepër një trafikanti. Ne presim nga ju që me ngulm të kërkonit nga ministritë tjera që me urgjencë t'i plotësojnë kriteret që janë të paplotësuara dhe sa jeni të koordinuar me ministritë tjera që të kërkonit plotësimin edhe të pikave të tjera të Rezolutës së miratuar në Kuvend, përveç pikës që i takon ministrisë suaj, që ka të bëjë me fushatën më intensive të vetëdijesimit, tha Vjosa Osmani.

Valdete Bajrami: pyeti se çfarë ndikimi mund të ketë shpërngulja e qytetarëve tanë në vendet e BE-së, në raport me procesin e liberalizimit të vizave.

Cilët janë hapat konkretë për këtë çështje në raport me BE-në dhe a keni të dhëna të sakta se sa qytetarë tanë gjinden në vendet e BE-së?

Ilir Deda: në diskutimin e tij tha se do të ndalet në tri fusha, MSA-ja, liberalizimi dhe eksodi i qytetarëve tanë.

Sa i përket MSA-së, Deda theksoi që edhe pse në raportin tuaj ministër kishit shkruar se Komisioni Evropian nuk dëshiron të ketë shpërndarje të tekstit, do ta lexoj nenin 2 të Komisionit edhe pse është në gjuhën angleze, po mundohem ta përkthej.

Citoj nenin 2, i cili thotë: “Asnjë nga termet, apo definicionet e përdorura në tekstet e MSA-së, anekset dhe protokollet e MSA –së, nuk e përmbajnë njohjen e Kosovës si shtet nga ana e BE-së dhe nuk e konstituon njohjen e Kosovës nga shtetet individuale që nuk e kanë njohur”.

Mendoni se kjo është jashtëzakonisht e dëmshme sa i përket shtetësisë së Kosovës dhe nëse e pranojmë një neutralitet të tillë, ne i bëjmë dëm aspiratave tona për njohjen universale të shtetësisë së Kosovës.

Në vazhdim Deda tha se nuk e di se a jeni në dijeni se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) , i ka dy dokumente që ne duhet të kërkojmë të na shpërndajë. Në dokumente zyrtare të kësaj ministrie dhe mënyra se si është negociuar MSA-ja nga MTI-ja, nuk parasheh rritje të eksportit por parashihet rritje e importit nga ana e BE-së në Kosovë për 7%, ngecje të importit në Kosovë dhe nuk parashihet zhvillimi social ekonomik me MSA-në, çfarë është negociuar deri më tani. Nuk pres nga ju ministër të më jepni përgjigje për këtë ministri, por kjo është një prej ministrive që është partnere në këtë fushë dhe analizën e MSA-së vet e ka negociuar, atëherë si

mund t'ju themi qytetarëve, se MSA-ja na garanton integrim në BE, kur nuk është e vërtetë dhe do të kemi rritje ekonomike dhe zhvillim social, kur në vet dokumentet e Qeverisë nuk është e vërtetë.

Sa i përket liberalizimit të vizave mendon se është pozitive nga ana e ministrit që ishte i sigurtë që tregoi që nuk po ka përkushtim në shumicën e institucioneve përgjegjëse dhe në raport është cek se çka duhet bërë.

Kurse sa i përket eksodit, që është duke ndodh, konsideron se nuk është në rregull me i fajësua qytetarët dhe nuk është korrekte me e hedh fajin te ta, duhet një reflektim i thellë me e pa pse njerëzit e kanë humbur shpresën dhe çka duhet të bëjmë të gjithë që shpresa t'ju kthehet.

Më tej Deda tha se sa për informim në tre muajt e fundit vetëm prej Merdarit dhe Dheut të Bardhë kanë dal 113 mijë qytetarë të Kosovës. Nëse flasim sinqerisht, atëherë e dimë edhe çka na pret nëse i kthejnë njerëzit tanë në Kosovë. Ajo shihet se bumi social dhe viti 2015, sa i përket shkaqeve ekonomike dhe shoqërore do të jetë vit i turbulencave. Askush nuk është i mashtruar që po ik prej Kosovës, por ekziston arsyeja e fortë e njerëzve që nuk po shohin të ardhmen e tyre këtu.

Kujtim Paçaku: tha se nuk guxojmë t'i fajësojmë qytetarët pse po ikin, fajin e kemi ne, migrimi i komunitetit RAE ka filluar në muajin mars dhe askush prej institucioneve nuk është deklaruar pse po largohet ky komunitet, deri me shkuarjen e mediave tona në shtetet ku shkojnë qytetarët tanë, atëherë u bë bujë më e madhe. Shpesh po dëgjoj në media dhe në Parlament për migrimin legal dhe migrimin ilegal, por nëse 100 mijë largohen, atëherë vihet në dyshim se migrimi a është ilegal apo jo. Në vazhdim i propozoj ministrit që pjesëtarët e komunitetit RAE, mos me i kthye sepse pjesa dërmuese i kanë shit shtëpitë e tyre, kanë qenë pa punë dhe kanë migruar dhe nuk kanë ku të kthehen, ata kanë migruar jo pse nuk e duan Kosovën, por kërkojnë vetëm punë.

Ministrja Çitaku në Qeverinë e kaluar ka bërë disa aktivitete në strategjinë e komunitetit RAE 2008-2015. Ajo ka udhëheq komisionet ndër-institucionale, kurse në planet e juaja nuk e pash se keni planifikuar ti keni këto aktivitete. Kërkoj që për pjesëtarët e komunitetit RAE të rrisin strategjinë 2015-2020 dhe gjatë strategjisë 2015, po mundohemi ta sjellim dekadën e romëve e cila është zhvilluar në të gjitha shtetet e regjionit, por nuk kemi mundur ta sjellim në Kosovë, të krijohet një sekretariat, i cili do të punon në strategjinë e komunitetit RAE dhe të vazhdohet të punohet seriozisht aty ku ka mbet znj.Çitaku..

Blerim Shala: theksoi se para disa viteve çështja e liberalizimit të vizave ka qenë ekskluzivisht çështje e përmbushjes së kriterëve, disponimi politik ka ekzistuar në Bruksel, nuk ka pas migrim të parregullt dhe gjithçka është lidh me përmbushjen e kriterëve, por fatkeqësisht është ndryshuar klima politike në Kosovë dhe kemi një migrim të parregullt që dëmton në mënyrë thelbësore liberalizimin e vizave.

Në vazhdim Shala tha se edhe nëse do t'i përmbushim kriteret, në ndërkohë në 3 deri në 6 muajt e ardhshëm, me gjasë ky vendim kësaj radhe do të jetë vendim ekskluzivisht politik, i cili do të ketë parasysh pasojat eventuale të mosdhënies së liberalizimit të vizave, andaj më shumë si shoqëri duhet të krijojmë situatën shumë më të volitshme në Kosovë, tash dhe me gjasë pyetja që ju bëhet juve ministër dhe neve si deputetë nga ana e Komisionit Evropian, është se çka do të bëni në ditën kur do të ndodh liberalizimi i vizave? A do të ketë dyndje të qytetarëve përmes aeroportit me pasaporta të rregullta, jo më në mënyrë ilegale dhe a kthehen pastaj ata qytetarë në Kosovë? Këtë problem e kanë pas Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi, prandaj pyetja ime më tepër ka të bëjë me segmentin politik jo në segmentin e përmbushjes së kriterëve, aty me gjasë kemi një konsensus edhe këtu dhe në Kuvendin e Kosovës, sepse Kuvendi i Kosovës asnjëherë nuk ka qenë pengesë për përsheptimin e procesit të liberalizimit të vizave për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, tha Shala.

Xhavit Haliti: theksoi se shumë herë raportet Qeveri- Parlament, tensionohen me arsye, por ju e dini se kontrolli politik dhe kontrolli i parlamentit duhet të jetë i vazhdueshëm në raport me

Qeverinë. Parlamenti nuk mund të jetë vetëm ti noterizojë vendimet e Qeverisë, por duhet të bëjë oponencën për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të ardhmen e vendit dhe ato që po ndodhin, duke përfshi të gjitha fushat.

Ju si ministri mbulon një sektor mjaft të rëndësishëm për ne dhe Kosovën në përgjithësi, prandaj pres një angazhim dhe bashkëpunim me të gjithë sektorët dhe të gjitha institucionet, si ministri jeni të obliguar të bashkëpunoni me të gjitha ministrinë, me të gjitha komunat dhe me të gjitha komunitetet, por kompetencat dhe mundësitë i keni të kufizuara, prandaj, nëse ndonjë herë ju sulmojmë, mos e merrni si për vete, por si çështje të Qeverisë në përgjithësi. Sa i përket liberalizimit të vizave, vazhdimisht kam qenë skeptik, duke pasqyruar edhe këtë që po na ndodh sot.

Haliti më tej tha se do të përmendi disa tëmeta tona që ju i përmendet shumë mirë, qoftë me rekomandimet e komisionit vlerësues dhe me ngërçin politik. Ne kemi deklarata të përhershme të ministrave dhe të ambasadorëve tonë që janë jashtë, të cilët flasin për mundësinë e marrëveshjes për punësim të përkohshëm. Mendoj që kur nuk ka diçka në rrugë e sipër për këtë çështje, nuk është mirë që të publikohet diçka që nuk është marrëveshje. Sa i përket çështjes së migrimit të pa rregullt dhe udhëtimit, ne jemi shtet dhe shteti duhet ta tregoj fuqinë e vet në raport me të gjithë shkelësit e ligjit, si të vendit tonë edhe vendeve tjera. Kemi mundësi me i ndal nëse angazhohet shteti. Ne e dimë të gjithë se shumica e tyre marrin certifikata të udhëtimit për fëmijë, mendoj që një vendim i Qeverisë për të ndaluar dhënien e certifikatave të udhëtimit për ata që nuk kanë viza për kalimin kufitar për fëmijët e tyre është i mundshëm, dhe të këtë pengesë për tu krijuar e gjithë kjo panik lidhur me eksodin.

E vërtetë është që situata e rëndë ekonomike e ka imponuar këtë, por nuk e besoj që nuk ka disa mekanizma shtesë, të cilat në një mënyrë ose tjetrën veprojnë që të dezinformojnë njerëzit për ta lëshuar në kufij dhe pastaj përplasja në stacion të autobusëve dhe në kufij me forca të rendit, është e vështirë, sepse nuk mund të përplasen aq lehtë me qytetarët e vet. Ne kemi marrë në Kuvend një agjendë për miratimin e legjislacionit dhe deri më tani nga Qeveria e Kosovës nuk kemi marrë asnjë ligj që i përket integritetit.

Në takimin e fundit që e kishim në Shqipëri, kemi vendos që të kemi takime të përbashkëta pune dhe jo vetëm vizita dhe për dallim nga herët tjera, që ata veç ata na kanë ftuar, kësaj radhe do ti ftojme në fillim ne dhe do te shohim si është puna. Në fund Haliti tha se në raport me Qeverinë është edhe një obligim i juaj, që të ushtroni presion me kërkesën tonë që ligjet e parapara në agjendën legjislative të Qeverisë të sillen në Parlament dhe të kalojnë në procedurën e miratimit.

Ministri Bekim Çollaku: theksoi se është e vërtetë se Plani i veprimit për MSA-në është inkadruar në Planin e veprimit të raportit të progresit, mirëpo, Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të raportit të progresit është një plan njëvjeçar dhe është plan vetëm për institucionet qeveritare dhe për këtë arsye nuk i është dërguar komisionit tuaj dhe Kuvendit për miratim, theksoi Bekim Çollaku, ministër për Integrimin Evropian.

Sa i përket substancës së përgjithshme, nuk ka dallim midis këtyre dy planeve, tha ai.

Emërtimi i këtij dokumenti është ndryshuar për atë se Qeveria ka vendosur që tani pas finalizimit të procesit negociator të MSA-së, të hartojë planin kombëtar të Acquis, i cili do të jetë dokumenti kryesor për zbatimin e obligimeve që derivojnë nga MSA-ja, pra synimi ynë që programi kombëtar të hartohet deri në fund të këtij viti. Sa përket strukturës dhe natyrës ky dokument do të përcaktojë masat që do të zbatohen nga Kosova, për të përmbushur standardet dhe kërkesat e BE-së në fushat e politikave, me qëllim të zbatimit të marrëveshjes së stabilizim asocimit, zbatimit të kriterëve afatmesme të studimit të fisibilitetit dhe përafrimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së dhe zbatimit të tij.

Sa i përket gjuhës së përmendur në dokument që ndërlidhet me shtetësinë e Kosovës, Çollaku tha se plotësisht pajtohet me z.Deda, por tha se nuk më takon mua t'ua sqarojë pse janë bërë këto. Aty jemi ballafaquar me një sfidë shumë të qartë, për shkak të 5 vendeve të BE-së, të cilat nuk na kanë njofur ende. Ky ka qenë çmimi që është dashtë ne ta paguajmë sa i përket dokumentit të

MSA-së, të gjitha pjesët tjera, përveç kësaj që është politike, janë në përputhje me MSA-në, që e kanë pasur shtetet tjera, të cilat kanë kaluar nëpër këtë proces.

Presioni për ta pranuar dokumentin si të tillë, ka qenë i jashtëzakonshëm, sepse pavarësisht mosnjohjes së 5 shteteve, i mundëson Kosovës në këtë fazë me lëviz përpara drejt këtij procesi.

Ne të gjithë po punojmë për këtë proces me bindjen se do të ndryshojnë edhe në raport me BE-në dhe në raport me 5 vendet që nuk na kanë njohur, sepse nëse edhe pas 10 vitesh përsëri do ta kemi gjendjen e njëjtë edhe perspektiva për anëtarësim të plotë do të ketë një pikëpyetje shumë të madhe.

Krejt kjo punë që po bëhet, theksoi Çollaku, po bëhet me synimin se gjërat do të ndryshojnë në favor të Kosovës dhe të shtetësisë së Kosovës në vitet e ardhshme.

Na nuk kemi nevojë që t'i gënjejmë qytetarët, por as vetveten. Këtu janë bë koncesione qysh janë bërë në të gjitha çështjet tjera, mirëpo, pavarësisht që duken të dhimbshme, së paku nuk e pengojnë Kosovën me lëviz përpara. Çka nëse ne u kishim thënë atyre se nuk e nënshkruajmë MSA-në pa figuruar Republika e Kosovës dhe përgjigja e tyre parimore pa asnjë hezitim do të ishte, jo, do të kishim ngecur aty ku jemi. Ne kemi bërë lëshime që janë të dhimbshme por që i hapin Kosovës rrugë të lëviz përpara, theksoi Çollaku.

Vjosa Osmani: u ndërlidh duke thënë se kryetarja e Komisionit për Integrim Evropian ka qenë pjesë e ekipit negociator, në qoftë se ekipi negociator e ka një kopje të MSA-së, atëherë edhe Komisioni duhet ta ketë një kopje.

Ministri Bekim Çollaku: tha se në takimin e fundit që e kam pas me BE-në ka qenë rekomandim që mos me u shpërnda.

Ilir Deda: reagoi duke thënë se jemi i vetmi vend që e ka rekomandim nga BE-ja mos me u shpërnda dhe për këtë do të ketë reagime.

Ministri Bekim Çollaku: tha se është e qartë për shkak të brengave që ende ekzistojnë në Komision për shkak të qasjes së 5 vendeve, që ende nuk na kanë njohur.

Ne ende nuk e dimë deri sa nuk e nënshkruajmë zyrtarisht komplet dokumentin, se a do të sjell Spanja ose Qipro ndonjë gjë tjetër, prandaj si i tillë është rekomanduar mos të shpërndahet, përndryshe nuk ka gjëra sekrete se ka të bëjë ma shumë me çështje tregtare të Kosovës dhe BE-së.

Sa i përket pyetjes për ligjet për liberalizim, janë 9 ligje, mirëpo, meqenëse asnjëra prej tyre nuk ka kaluar ende në Qeveri, atëherë llogariteni sa kohë mund të marrë, prandaj në këtë aspekt kërkoj nga Komisioni që në momentin që miratohen në Qeveri dhe vijnë në Kuvend, të procedohen sa më parë për atë që lejojnë procedurat dhe rregullat e Parlamentit dhe të miratohen, sepse do të humbim shumë kohë.

Sa i përket afateve kohore, Çollaku tha se kishte menduar që pas 6 muajve të humbur, në 3 muajin e par të këtij viti do të ketë dinamizëm që të punohet seriozisht, por në fushën e liberalizimit të vizave dhe kriteret e mbetura, nuk kam par asnjë lloj progresi, por pres që në 3 muajin e ardhshëm me u përmbush në tërësi kriteret. Qëllimi është që kur jemi 100% të sigurt ta dërgojmë raportin dhe pastaj kur ata e dërgojnë misionin e tyre verifikues, mos të thonë se nuk janë bërë ashtu si duhet.

Pavarësisht sa kohë do të humbim, ne nuk do të dërgojmë raport Komisionit Evropian, pa u përmbush të gjitha kriteret sipas udhëzuesit për liberalizim të vizave. Nuk do të duhej të zgjaste më shumë se tre muaj, mirëpo, duke par ngecjet e deritanishme, vështirë është të parashikohet. Nëse deri në fillim të verës e dërgojmë raportin me të gjitha detyrat e përmbushura, unë pres që Komisioni ka me lëviz edhe pse koha është e papërshtatshme sepse në verë si në Kosovë ashtu edhe në Bruksel, janë pushimet e verës, mirëpo, ka një zotim dhe një përkushtim edhe nga ana e tyre sepse edhe ata janë të bindur se në rastin e Kosovës shumë gjëra kanë shkuar keq.

Fillimisht kanë filluar ndryshe sepse na kanë dhënë dyfish më shumë kriteret dhe klima në BE ka ndryshuar për të keq, në të gjitha takimet e mia ua kam bërë të qartë se neve nuk na intereson

çfarë klime ekziston në BE, sepse atyre u takon në Komisionin Evropian t' i bindin vendet anëtare se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret teknike me udhërrëfyes dhe duhet t'na vlerësojnë në bazë të kriterëve e jo në bazë të klimës që mbretëron atje.

Mirëpo siç u tha edhe nga z.Shala, në fund pavarësisht përmbushjes së kriterëve, ky vendim do të jetë politik dhe pres që të gjitha institucionet në Kosovë, kudo që kanë mundësi në bashkëveprim me shtetet anëtare të BE-së, të jenë shumë më këmbëngulëse në kërkesat tona politike që Kosova në këto dy aspekte ta marrë atë çfarë pret dhe e meriton. Personalisht mendoj se nëse çdo gjë do të shkojë sipas kësaj dinamike, në fund të vitit Komisioni Evropian duhet të jetë në gjendje që të jep një raport përfundimtar, që Kosova i ka përmbush kriteret. Por duhet të jemi realistë sepse nuk pres që Komisioni ti rekomandojë Këshillit e pastaj Parlamentit që të merr vendim që gjatë këtij viti Kosovës ti hiqen vizat.

Sa i përket pyetjes për efektin e migrimit të parregullt, s'ka dyshim se ky migrim prodhon vetëm efekte negative, që ndërlidhen me këtë proces, mirëpo, prapë se prapë që ky trend është ne rritje nuk guxon me e rreziku seriozisht rekomandimin për liberalizim të vizave, sepse neve fillimisht duhet t'na mundësohet një gjë e tillë dhe pastaj të na gjykojnë se sa ne po i përmbushim ato kriteret për liberalizim të vizave, pastaj ne nëse nuk performojmë, komisioni përsëri e ka mekanizmin për tërheqjen e kësaj mase, tha ministri Çollaku.

Për pyetjen e z. Shala se a do të ketë një eksod pas liberalizimit të vizave, personalisht nuk pres një entuziazëm të tillë. Pajtohem me ju që faktor shtytës që i shtyn njerëzit me dal jashtë është një jetë dhe mirëqenie me e mirë, mirëpo, mund të them se ka edhe faktorë tjerë që lidhen me krim të organizuar dhe me çështje të tjera, por faktorë determinues janë kushtet sociale dhe ekonomike. Këtu gjërat duhet të ndërrojnë në mënyrë shumë radikale në kuptimin e zhvillimit ekonomik dhe krijimin e politikave shumë ma të mira sociale. Shpresoj që ju do t'i ftoni ministrat përkatës në komisionin tuaj, që nga dora e parë t' ju njoftojnë për planet e tyre konkrete, tha Çollaku.

Sa i përket shifrave të migrimit, Iliri përmendi shifra marramendëse, por ato shifra nuk janë zyrtare për azil, por janë hyrje- dalje të qytetarëve tonë dhe ne nuk e dimë se a janë duke shkuar për azil apo për diçka tjetër. Ne flasim vetëm me të dhëna të EUROSTATIT dhe ato i kemi vetëm për vitin e kaluar, që japin shifrën për 26 mijë veta.

Pajtohem që këta dy muaj fluksi ka qenë mjaftë i madh, por mos të spekulojmë me numra sepse nuk është as në interesin tonë. Mirëpo, një e dhënë tjetër që len hapësirë për shpresë është fakti që shumica dërmuese e tyre po kthehen dhe do të kthehen.

Sa i përket pyetjes që ti bëjmë thirrje komunitetit RAE, që mos të kthehet në Kosovë, mund t' ju them se askush nga shtetet e BE-së nuk e pyet Kosovën dhe nuk kemi asnjë qasje kënd me e kthye e kënd jo, secili shtet i gjykon vet se kujt i jep azil e kujt jo, ne me shumicën e këtyre shteteve kemi marrëveshje për riatdhesim dhe ne duhet ta marrim barrën e riintegrit të këtyre njerëzve në shoqërinë tonë, theksoi Çollaku.

Ilir Deda: tha se për hir të korrektesisë në opinion, EUROSTATI jep të dhëna vetëm për njerëzit që kanë kërkuar azil, mirëpo, migrimi ilegal thotë se njerëzit qëndrojnë ilegalisht dhe ne prej EUROSTATIT nuk mund të marrim vesh sa njerëz kanë migruar.

Në vazhdim pyeti për marrëveshjen kornizë, e cila tash katër vite pritet të nënshkruhet, por as me fusnotë nuk lejojnë nënshkrimin e saj, çka po ndodh me këtë fushë dhe ne do t'ua bëjmë të qartë edhe shteteve tjera që nuk po na njohin se ata e kanë obligim për stabilitet dhe zhvillim të këtij kontinenti dhe Ballkanit perëndimor dhe se Kosova e mbyllur nuk i kontribuon asaj. Si do të nënshkruhet marrëveshja kornizë.

Ministri Çollaku: tha se ne e dimë të gjithë se Kosova nuk është fokusi as i BE-së dhe as i partneritet tonë strategjik SHBA-së. Tani vëmendja është vendosur në Ukrainë dhe kjo sjell pasoja shumë anësore sepse nuk e kemi vëmendjen që e kemi pasur dikur. Mirëpo, nëse edhe këtë vit qytetarët tonë nuk e prekin perspektivën evropiane, nuk e di se kur mundemi me prek. Nëpër të gjitha takimet e mëhershme me përfaqësuesit evropianë, ju kam thënë se nëse ju nuk ua mundësoni qytetarëve tanë me e prek këtë perspektivë, duhet të na izoloni edhe neve si

politikan sepse ne nuk kemi nevojë të vijmë në Bruksel e të flasim kot, e qytetarët tanë mos të mund ta realizojnë një të drejt fundamentale. Besoj se janë të vetëdijshëm për këtë, por sinqerisht edhe ne duhet të bëjmë më shumë edhe ndoshta në aspektin e bashkëpunimit bilateral me shtetet liderë të BE-së, që ta marrim një vendim të merituar për Kosovën për këto dy procese, tha Çollaku.

Sa i përket marrëveshjes që ndërlidhet me programet e ndryshme të BE-së, e kam ngrit disa herë. Çelësi ekziston te nënshkrimi i MSA-së, në qoftë se nuk do te ekzistojë asnjë lloj komplikimi me MSA-në, e njëjta formulë do të përdoret për të gjitha këto programe. Është e vërtetë se Kosova ka pësuar nga mospasja qasje në fonde të ndryshme të BE-së.

Sa i përket strategjisë për komunitetin RAE, Çollaku tha se strategjia në fjalë është ende ne fuqi dhe si qeveri jemi të përkushtuar ta vazhdojmë ta implementojmë. Unë si ministër kam bërë një vizitë në Gjakovë te komuniteti RAE dhe kam komunikuar me ta, në mënyrën më të hapur dhe i di problemet e tyre. E di se është bërë diçka për ta nga qeveria paraprake për mbylljen e atyre vendbanimeve informale, proceset e rindërtimit të shtëpive të reja janë në proces dhe gjithashtu përmirësimi i infrastrukturës, mirëpo, shumica e këtyre projekteve ndërlidhen me vet komunitat dhe ne të gjithë jemi te vetëdijshëm për atë se çfarë kapaciteti të buxhetit kanë disa komuna dhe nuk varet vetëm nga niveli qendror dhe ne si ministri kemi vetëm rol koordinues të këtyre politikave dhe këtë do të vazhdojmë ta bëjmë më me ngulm, jo vetëm gjatë këtij viti, por edhe gjatë viteve tjera, aq sa na mundëson buxheti. E di se komuniteti RAE ka më shumë nevojë, por ne si Qeveri duhet të krijojmë kushte të barabarta përpara ligjit për të gjitha komunitetet dhe sipas kushteve që i kemi do të ndihmojmë, tha ministri Çollaku.

Kujtim Paçaku: tha se Ministria për Komunitete e ka financuar vetëm një komunitet kurse tjerat jo. Ju keni thënë gjithnjë se Kosova duhet të jetë e barabartë me shtetet tjera, andaj edhe komuniteti RAE kërkon të jetë i barabartë me komunitetet tjera, këtu qëndron dallimi.

Luljeta Veselaj – Gutaj: tha se ju ministër theksuat që gjatë tremujorit të ardhshëm pritni që do të jetë data kur do ta dorëzoni raportin final, por megjithatë duhet shumë punë edhe nga ana e ministrive të tjera, duke marr parasysh edhe 9 ligje të tjera, që duhet të sillen në Kuvend. A keni pas ndonjë takim me kolegët tjerë ministra për t'i përshpejtuar punët dhe për ti dhënë një intensitet punëve në ministrit, për ti miratuar ligjet përkatëse që të finalizohet raporti, për ti dhënë datë liberalizimit të vizave.

Ministri Çollaku: sqaroi se Ministria për Integritet Evropian ka kontakt të përhershëm me të gjitha ministrinë dhe ka për detyrë të koordinojë aktivitetet me të gjitha ministrinë, ndërsa për çështjet specifike që ndërlidhen me përmbushjen e kriterëve, jo më larg se javën e kaluar, tha kemi pas takimin me komitetin drejtues që është niveli më i lart ne aspektin qeveritar në fushën e liberalizimit të vizave dhe aty të gjithë ministrat përkatës që kanë ngecje në këtë aspekt, kanë raportuar dhe kanë dhënë një pasqyrë se ku qëndrojnë, për pritjet e tyre se kur mund t'i përmbushin detyrat e mbetura, kështu që edhe raporti im i sotëm, është duke iu referuar imputit që kam marr nga takimi i kaluar dhe dua ti besoj zotimit të ministrave në atë takim.

Kryetarja Teuta Sahatqija: falënderoi ministrin për raportim dhe tha se beson që edhe më tutje do të takohen në Komision dhe do t' i koordinojnë veprimet që efektet të jenë sa më të mëdha në dobi të proceseve integruese dhe të qytetarëve.

Të ndryshme.

Kryetarja Teuta Sahatqija: njoftoi se është riaktualizuar edhe një herë kërkesa për pranimin e Komisionit të Integritet Evropian në Konferencën e Komisioneve për Integritet Evropian të Rajonit (COSAP) sepse Kosova nuk është anëtare e barabartë.

E kemi dërguar edhe njëherë kërkesën dhe ndërkohë kemi marr një ftesë, ku Serbia është kryesuese e COSAP. Konferenca do të mbahet në Beograd, kurse në agjendë nuk ishte kërkesa

jonë, andaj kam shtruar kërkesën, ku kam kërkuar që të futet në rend të ditës anëtarësimi i Kosovës.

Sahatqija njoftoi edhe për ftesën që i është bërë ministrit për punë të brendshme, për raportim në Komision dhe për organizimin e një tryeze, drekë pune në bashkëpunim me GIZ-in, që do të mbahet të martën, më 24 shkurt, me temën „Roli i Komisionit për Integritet Evropian në procesin e Integriteteve Evropiane dhe përafrimin e ligjeve”.

Vjosa Osmani: tha se pasi që komisionari Han gjatë vizitës së tij në Kosovë, nuk kishte paraparë të takohet me Komisionin për Integritet, kërkoi që ti bëhet kërkesë për takim me Komisionin.

Ilir Deda: propozoi që javën e ardhshme të ftohet në takim z. Samuel Zhbogar.

Kryetarja Teuta Sahatqija: u dakordua me kërkesën e anëtarëve, që të bëhet kërkesë për takim me komisionarin Han dhe ftesa për takim ti dërgohet edhe z. Samuel Zhbogar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Teuta Sahatqija